LIGJ
Nr. 139/2014

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE TË MARRËVESHJES SË HUAS DHE PROGRAMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, E FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT DHE KFW FRANKFURT AM MAIN PËR FINANCIMIN E PROGRAMIT "FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE IV"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese e marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit "Fondi i investimeve sociale IV".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 16.10.2014

Shpallur me dekretin nr. 8771, datë 4.11.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

KfW Bankengruope, Postfach 111141,60046 Frankfurt am Main
Faks: (+355) 4 222 8494
Republika e Shqipërisë
Përfaqësuar nga
Ministria e Financave
Blvd. "Dëshmorët e Kombit", nr. 1
Tiranë
Shqipëri

Për dijeni
Faks: (+355)4 22 34885
Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rr. "Sami Frashëri", nr. 10
Tiranë

Datë 20/12/2013

Sfera e Biznesit
KfW Entwicklungsbank

Stefan Krus
Our ref.: KSt
Tel.+49 69 7431 3674
Faks: +49 69 7431-2004
stefan.krus@kfw.de

Ndryshim i Marrëveshjes së Huas nr. 24916 për 20 milionë euro, ndërmjet KfW-së dhe Republikës së Shqipërisë, dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, të datës 23 dhjetor 2010-Fondi i Investimeve Sociale IV.

Të nderuar zotërinj,

Ne i referohemi Marrëveshjes së Huas prej 20 milionë euro (Marrëveshja e Huas), e cila është nënshkruar më 23 dhjetor 2010 ndërmjet KfW-së si Huadhënës dhe Republikës së Shqipërisë si Huamarrës, dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit si Agjenci e Zbatimit të Projektit. Përveç kur shfaqet një synim i kundërt, termat me germa kapitale të përkufizuara në Marrëveshjen e Huas kanë të njëjtin kuptim në këtë letër.

Marrëveshja e Huas ndryshohet si më poshtë:

Neni 3.2 "Afati për kërkimin e disbursimit" zëvendësohet me sa më poshtë:

"KfW-ja mund të refuzojë disbursimet pas datës 30.6.2017.".

Aneksi 1 "Grafiku i Disbursimit" zëvendësohet me sa më poshtë:

"Në fund të çdo periudhe të përcaktuar më poshtë, Huamarrësi ka kërkuar disbursimin e shumave të Huas që nuk kalojnë në total shumën e treguar më poshtë për çdo periudhë. Në masën që Agjencia e Zbatimit të Programit kërkon disbursime të shumave më të vogla brenda një periudhe gjashtëmujore, shumat e padisbursuara mund të kërkohen në gjysmën e vitit pasues.".

Të gjitha shifrat në euro	Disbursuar në periudhën përkatëse	Disbursuar në periudhat e mëparshme	Disbursimet e përgjithshme
01/01/13-30/06/13	628.000.00 euro	0	628.000.00 euro
01/07/13-31/12/13	1.020.000,00 euro	628.000.00 euro	1.648.000,00 euro

01/01/14-30/06/14	1.800.000,00 euro	1.648.000,00 euro	3.448.000,00 euro
01/07/14-31/12/14	2.900.000,00 euro	3.448.000,00 euro	6.348.000,00 euro
01/01/15-30/06/15	13.652.000,00 euro	6.348.000,00 euro	20.000.000,00 euro

*Shuma totale maksimale e akumuluar që mund të disbursohet deri në fund të secilës periudhë disbursimi

Duke nënshkruar këtë letër ndryshimi dhe duke iu referuar fakteve dhe rrethanave ekzistuese, Huamarrësi dhe Agjencia e Ekzekutimit të Programit përsërisin përfaqësimin dhe deklarimet e parashikuara në nenin 13.1 të Marrëveshjes së Huas.

Kjo letër nuk ndryshon asnjë dispozitë tjetër të Marrëveshjes së Huas dhe nuk përbën heqje dorë në lidhje me ndonjë prej të drejtave tona sipas Marrëveshjes së Huas.

Kjo letër rregullohet nga ligji gjerman.

Jeni të lutur të bëni të ditur pranimin tuaj për termat dhe kushtet e kësaj letre, duke e nënshkruar ku tregohet më poshtë dhe duke i kthyer një kopje origjinale KfW-së.

Me respekt
KfW
(firmë) (firmë)
Andreas Rahe Stefan Krus

Ne biem dakord për çështjet e parashikuara në letrën tuaj të datës 20 dhjetor 2013, ku kjo është kopje e saj.

Për dhe në emër të Ministrisë së Financave
Emri:
Titulli:

Për dhe në emër të Fondit Shqiptar të Zhvillimit
Emri:
Titulli: